

Manuali I Përdorimit **MONITOR IPS LED** **(MONITOR LED*)**

***Monitorët LED LG janë monitorë LCD me ndriçim të pasmë LED.**

Lexoni me kujdes informacionin mbi sigurinë përpara përdorimit të produktit.

Lista e modeleve të monitorit IPS LED Monitor (Monitori LED)

43UD79

43UD79T

PASQYRA E LËNDËS

3 LICENCA

4 MONTIMI DHE PËRGATITJA

- 4 Përbërësit e produktit
- 5 Drajverat dhe softuerët e suportuar
- 6 Përshkrimi i përbërësve dhe i butonave
- 6 - Përdorimi i butonit të levës
- 7 - Përdorimi i butonit të levës
- 8 Bashkuesi i hyrjes
- 10 Lëvizja dhe ngritja e monitorit
- 11 Instalimi i monitorit
- 11 - Montimi i bazamentit mbajtës
- 12 - Montimi i bazamentit mbajtës
- 13 - Përdorimi i mbajtësit të kabllit
- 14 - Instalimi mbi tavolinë
- 15 - Rregullimi i këndit
- 15 - Përdorimi i siguresës Kensington
- 16 - Instalimi i pllakës për montim në mur
- 16 - Instalimi në mur

18 TELEKOMANDA

19 PËRDORIMI I MONITORIT

- 19 Lidhja me kompjuterin
- 19 - Lidhja HDMI
- 19 - Lidhja e DisplayPort
- 20 - Lidhja USB-C
- 20 Lidhja me pajisjet AV
- 20 - Lidhja HDMI
- 21 Lidhja e periferikeve
- 21 - Lidhja me kabllo USB - kompjuter
- 22 Lidhja me pajisjet e jashtme
- 22 - Lidhja e kufjeve

23 PARAMETRAT E PËRDORUESIT

- 23 Aktivizimi i menysë kryesore
- 23 - Veçoritë e menysë kryesore
- 24 Parametrat e përdoruesit
- 24 - Parametrat e menysë

29 ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

31 SPECIFIKIMET

- 31 43UD79
- 32 43UD79T
- 33 Regjimi mbështetës i fabrikës (Preset Mode, PC)
- 33 HDMI
- 34 DisplayPort / USB-C
- 35 Sinkronizimi i HDMI (Video)
- 35 Drita LED e energjisë

36 EXTERNAL CONTROL DEVICE SETUP

- 36 - Communication Parameters
- 36 - Transmission
- 36 - OK Acknowledgement
- 36 - Error Acknowledgement
- 37 - Command Reference List

LICENCA

Çdo model ka licencë të ndryshme. Vizitoni www.lg.com për më shumë informacion mbi licencën.



The terms HDMI and HDMI High-Definition Multimedia Interface, and the HDMI logo are trademarks or registered trademarks of HDMI Licensing LLC in the United States and other countries.



VESA, logoja VESA, logoja DisplayPort Compliance dhe logoja DisplayPort Compliance për pajisjet me burim me modalitet të dyfishtë janë të gjitha marka të regjistruara tregtare të Video Electronics Standards Association.



The SuperSpeed USB Trident logo is a registered trademark of USB Implementers Forum, Inc.

Materiali i mëposhtëm zbatohet vetëm për monitorin i cili shitet në tregun e Europës dhe i cili përmbush nevojat e Direktivës ErP:

* Ky monitor është vendosur që të fiket automatikisht pas 4 orësh pasi të keni ndezur ekranin nëse nuk i bëhet asnjë ndryshim ekranit.

* Për ta çaktivizuar këtë parametër, ndryshoni opsionin në 'Off' në menunë OSD të "Automatic Standby(automatik koha e pritjes)!"

MONTIMI DHE PËRGATITJA

SHQIP

Përbërësit e produktit


Përpara se ta përdorni produktin, ju lutemi të kontrolloni nëse të gjithë përbërësit janë brenda kutisë. Nëse ka përbërës që mungojnë, kontaktoni dyqanin ku keni blerë produktin. Mbani parasysh se produkti dhe përbërësit mund të duken ndryshe nga ato që tregohen këtu.




CD(manuali i përdorimit)/Kartë




Kordoni elektrik
(Në varësi të shtetit)




Telekomanda, Bateritë (AAA)




Gjinia RS-232C
(Ky kabëll përshtatësi nuk përfshihet në të gjitha vendet.)




Kabëll HDMI
(Kjo kablo nuk përfshihet për të gjitha vendet.)



Kabloja e folesë së ekranit
(Kjo kablo nuk përfshihet për të gjitha vendet.)




Kabëll USB C-C
(Kjo kablo nuk përfshihet për të gjitha vendet.)



Gjinia USB C-A
(Ky kabëll përshtatësi nuk përfshihet në të gjitha vendet.)

43UD79




Trupi i mbështetëses



Baza e mbështetëses



Mbajtësi i kabllit




Dera e Pasmë



4 vida


43UD79T



Baza e mbështetëses



4 vida



Mbajtësi i kabllit



Dera e Pasmë

**KUJDES**

- Për të garantuar sigurinë dhe performancën e produktit përdorni gjithmonë pjesë origjinale.
- Çdo dëmtim apo lëndim i shkaktuar nga përdorimi i pjesëve jo origjinale nuk mbulohet nga garancia e produktit.
- Rekomandohet përdorimi i pjesëve të ofruara.
- Nëse përdor kablo të zakonshme të pacertifikuara nga LG, ekrani mund të mos shfaqë figurë ose figura mund të jetë me zhurmë.

**SHËNIM**

- Mbani parasysh se pjesët përbërëse mund të duken të ndryshme nga ato që tregohen këtu.
- I gjithë informacioni dhe specifikimet në këtë manual i nënshtrohen ndryshimit pa njoftim paraprak, me qëllim përmirësimin e performancës së produktit.
- Për të blerë aksesore opsionale, vizitoni një dyqan pjesësh elektronike ose faqen e blerjeve në internet ose kontaktoni dyqanin ku keni blerë produktin.

Drajverat dhe softuerët e suportuar


Kontrollo drajverat dhe softuerët e suportuar nga produkti dhe shih manualet në CD-në që vjen me paketimin e produktit.

Drejtuesit dhe softueri	Përparësia e instalimit	43UD79,43UD79T
Drejtuesi i monitorit	Rekomanduar	0
On Screen Control	Rekomanduar	0
Dual Controller	Opsionale	0

- Nevojitet dhe rekomandohet: Mund të shkarkoni dhe të instaloni versionin e fundit nga CD-ja që vjen me produktin ose nga faqja e LGE (www.lg.com).
- Opsionale: Mund të shkarkoni dhe të instaloni versionin e fundit nga faqja e LGE (www.lg.com).

Përshkrimi i përbërësve dhe i butonave

43UD79



Përdorimi i butonit të levës

Mund t'i kontrolloni me lehtësi funksionet e monitorit duke shtypur butonin e levës ose duke e lëvizur atë majtas/djathtas me gisht.


Funksionet bazë

		Ndezja	Prekeni njëherë me gisht butonin e levës për të ndezur monitorin.
		Fikja	Shtypni dhe mbani shtypur me gisht butonin e levës për të fikur monitorin.
		Kontroli i volumit	Mund ta kontrolloni volumin duke e lëvizur butonin e levës majtas/djathtas.

SHËNIM

- Butoni i levës gjendet në pjesën e poshtme të monitorit.

43UD79T



Përdorimi i butonit të levës

Mund t'i kontrolloni me lehtësi funksionet e monitorit duke shtypur butonin e levës ose duke lëvizur atë majtas/djathtas me gisht.

Funksionet bazë



		Ndezja	Prekeni njëherë me gisht butonin e levës për të ndezur monitorin.
		Fikja	Shtypni dhe mbani shtypur me gisht butonin e levës për të fikur monitorin.
		Kontrolli i volumit	Mund ta kontrolloni volumin duke lëvizur butonin e levës majtas/djathtas.

SHËNIM



- Butoni i levës gjendet në pjesën e poshtme të monitorit.

Bashkuesi i hyrjes

43UD79




43UD79T




Lëvizja dhe ngritja e monitorit

Kur të lëvizni ose ngrini monitorin, ndiqni këto udhëzime për të parandaluar gërvishtjen apo dëmtimin dhe për të garantuar transportim të sigurt, pavarësisht formës apo madhësisë së tij.

- Këshillohet që ta vendosni monitorin në kutinë origjinale ose në materialin e paketimit përpara se të përpiqeni ta lëvizni atë.
- Përpara se ta lëvizni apo ta ngrini monitorin, shkëputni kordonin elektrik dhe të gjitha kabllo.
- Mbajeni fort pjesën e sipërme dhe të poshtme të kornizës së monitorit. Mos e mbani vetë ekranin.




- Kur ta mbani monitorin, ekranin nuk duhet të jetë drejtuar nga ju në mënyrë që të parandalohen gërvishtjet.




- Kur të lëvizni monitorin, shmangni goditje të forta apo dridhje të produktit.
- Kur ta lëvizni monitorin mbajeni drejt, kurrë mos e ktheni nga anët dhe as mos e anoni atë.

! KUJDES


- Shmangni preken e ekranit të monitorit sa më shumë të jetë e mundur. Kjo mund të shkaktojë dëmtim të ekranit ose të disa pikëzave që përdoren për krijimin e figurave.



ose



- Nëse e përdorni panelin e monitorit pa bazën e mbështetëse, butoni i levës mund të bëjë që monitori të jetë i paqëndrueshëm dhe të bjerë, duke sjellë dëmtimin e monitorit ose lëndim personi. Përveç kësaj, kjo mund të sjellë keqfunksionim të butonit të levës.




Instalimi i monitorit


Montimi i bazamentit mbajtës

43UD79

- 1 Lutem vendosni një copë të butë në një tavolinë të ulët apo kuti për të mbrojtur ekranin e monitorit.





- 2 Lutem vendosni monitorin mbi copën e butë me ekran të kthyer nga poshtë.




- 3 **1** Montoni **Koka** dhe **Trupi i mbështetëses**.

- 2** Montoni **Trupi i mbështetëses** dhe **Baza e mbështetëses**.

Rotulloni vidën në drejtin të kundërt të akrepave të sahatit për të siguruar **Baza e mbështetëses**.



- 4 Montoni **Koka** dhe Derën e Pasma.



PARALAJMËRIM


- Për të shmangur dëmtime të mundshme të gishtave dhe këmbëve, gjatë procesit të montimit të **Trupi i mbështetëses** dhe **Baza e mbështetëses**, mbani të fiksuar Bazën në kohën që montoni **Trupi i mbështetëses** dhe **Baza e mbështetëses**.
- Mos vendos substanca të huaja (vajra, lubrifikantë etj.) në pjesët e vidhosjes gjatë montimit të produktit.
(Përndryshe, produkti mund të dëmtohet.)




Montimi i bazamentit mbajtës

43UD79T


- 1 Lutem vendosni një copë të butë në një tavolinë të ulët apo kuti për të mbrojtur ekranin e monitorit.




- 2 Lutem vendosni monitorin mbi copën e butë me ekran të kthyer nga poshtë.



- 3 Montoni **Koka** dhe **Derën e Pasme**.



- 4 Montoni **Baza e mbështetëses** dhe **Koka**. Rrotulloni vidën në drejtin të kundërt të akrepave të sahatit për të siguruar **Baza e mbështetëses**.



PARALAJMËRIM

- Për të shmangur dëmtime të mundshme të gishtave dhe këmbëve, gjatë procesit të montimit të **Trupi i mbështetëses** dhe **Baza e mbështetëses**, mbani të fiksuar Bazën në kohën që montoni **Trupi i mbështetëses** dhe **Baza e mbështetëses**.
- Mos vendos substanca të huaja (vajra, lubrifikantë etj.) në pjesët e vidhosjes gjatë montimit të produktit.
(Përndryshe, produkti mund të dëmtohet.)



**KUJDES**



- Ilustrimet në këtë dokument përfaqësojnë procedurat tipike, kështu që mund të duken ndryshe nga produkti real.
- Mos e mbani monitorin përmbys duke e mbajtur vetëm nga baza e mbështetëses. Kjo mund të shkaktojë shpëputjen e monitorit nga mbështetësja dhe mund të çojë në lëndim personal.
- Mos e prekni ekranin e monitorit ndërkohë që ngrini ose lëvizni monitorin. Forca e ushtruar në ekranin e monitorit mund t'i shkaktojë dëmtime.
- Mos vendos substanca të huaja (vajra, lubrifikantë etj.) në pjesët e vidhosjes gjatë montimit të produktit. (Përndryshe, produkti mund të dëmtohet.)
- Ushtrimi i forcës së tepërt kur shtrengoni vidat mund të shkaktojë dëmtim të monitorit. Dëmtimi i shkaktuar në këtë mënyrë nuk mbulohet nga garancia e produktit.

**SHËNIM**

- Mund ta çmontoni mbështetësen duke i kryer veprimet e montimit në rend të kundërt.


Përdorimi i mbajtësit të kablilit

Sistemoji kabllo me mbajtësin e kabllove siç tregohet në figurë.


43UD79**43UD79T****Mbajtësi i kablilit**

Instalimi mbi tavolinë


- 1 Ngrijeni monitorin dhe vendoseni mbi tavolinë në pozicionin drejt.
Vendoseni të paktën **100 mm** larg nga muri për të siguruar ajrim të mjaftueshëm.




ose



- 2 Mbylleni kabllin e Energjisë me monitorin, pastaj futeni kabllin e energjisë në prizë. .



ose




- 3 Shtypni butonin e levës në pjesën e poshtme të monitorit për ta ndezur monitorin.

⚠️ KUJDES

- Hiqeni nga prizat kabllon elektrike përpara se ta zhvendosni ose ta instaloni monitorin. Ekziston rreziku i goditjes elektrike.

Masat e kujdesit gjatë lidhjes së kordonit elektrik



100-240 V ~


- Sigurohuni që të përdorni kordonin elektrik që jepet në paketën e produktit dhe lidheni me një prizë elektrike të tokëzuar.
- Nëse ju duhet kordon tjetër elektrik, kontaktoni shitësin lokal ose dyqanin më të afërt të shitjeve me pakicë.

Rregullimi i këndit

- 1 Vendoseni monitorin në pozicion drejt, të montuar në bazën e mbështetëses.
- 2 Rregullojeni këndin e ekranit. Këndi i ekranit mund të rregullohet përpara ose prapa për një shikim më të rehatshëm.

43UD79

10° -5°




Ana e pasme

Ana e përparme


! PARALAJMËRIM

- Për të shmangur lëndimin e gishtave kur rregulloni ekranin, mos e mbani pjesën e poshtme të skeletit të monitorit siç ilustronet më poshtë.


43UD79



- Bëni kujdes të mos prekni ose të mos ngjishni sipërfaqen e ekranit kur rregulloni këndin e monitorit.



ose




Përdorimi i siguresës Kensington


Bashkuesi i sistemit të sigurisë Kensington ndodhet në pjesën e pasme të monitorit.

Për më shumë informacion mbi instalimin dhe përdorimin, referojuni manualit të përdorimit të siguresës Kensington ose vizitoni faqen e internetit <http://www.kensington.com>.

Lidhni kabllon e sistemit të sigurisë Kensington ndërmjet monitorit dhe tryezës.



ose



! SHËNIM

- Përdorimi i kyçit Kensington është opsional. Aksesoret mund t'i blini në dyqanin tuaj lokal të pjesëve elektronike.

Instalimi i pllakës për montim në mur

Ky monitor mbështet specifikimin e pllakës standarde për montim në mur ose pajisjes së përputhshme.


- 1 Vendoseni ekranin përmbys. Për ta mbrojtur ekranin nga gërvishtjet, mbulojeni sipërfaqen me një leckë të butë.
- 2 Vendoseni pllakën për montim në mur mbi monitor dhe bashkërenditeni me vrimat e vidave.
- 3 Shtrëngoni katër vidat për të fiksuar pllakën me monitorin me anë të një kaçavide.

! SHËNIM

- Pllaka për montim në mur shitet më vete.
- Për më shumë informacion mbi instalimin, referojuni udhëzuesit të instalimit të pllakës për montim në mur.
- Kini kujdes të mos përdorni forcë të tepërt kur të montoni pllakën e montimit në mur sepse kjo mund të dëmtojë ekranin e monitorit.

Instalimi në mur

Instalojeni monitorin të paktën 100 mm larg nga muri dhe lini një hapësirë rreth 100 mm në secilën anë të monitorit për të garantuar ajrimin e duhur. Udhëzimet e hollësishtme të instalimit mund t'i merrni në dyqanin tuaj lokal. Ju lutemi referojuni manualit për instalimin dhe montimin e një mbajtëseje me anim për montim në mur.




Për të instaluar monitorin në mur, vendosni kapëse për montim në mur (opsionale) në pjesën e pasme të monitorit.

Sigurohuni që mbajtësja për montim në mur të jetë e shtrënguar fort në monitor dhe në mur.

- 1 Nëse përdorni vida më të gjata se standardet, monitori mund të dëmtohet nga brenda.
- 2 Nëse nuk përdorni vidat e duhura, produkti mund të dëmtohet dhe të bjerë nga pozicioni i montuar. Në këtë rast, LG nuk është përgjegjëse për të.

Wall Mount (A x B)	200 x 200
Vidë standarde	M6
Numri i vidave	4
Pllaka për montim në mur (Opsionale)	LSW240B

- Wall Mount (A x B)



KUJDES

- Hiqeni nga priza kabllon elektrike përpara se ta zhvendosni ose ta instaloni monitorin për të evituar goditjet elektrike.
- Instalimi i monitorit në tavan ose në një mur të pjerrët mund të rezultojë në rrëzimin e monitorit, gjë e cila mund të shkaktojë lëndim. Ju lutemi, përdorni kllapën origjinale LG për montimin në mur. Për më shumë informacion kontaktoni dyqanin tuaj lokal ose një instalues të kualifikuar.
- Ushtrimi i forcës së tepërt kur shtrëngoni vidat mund të shkaktojë dëmtim të monitorit. Dëmtimi i shkaktuar në këtë mënyrë nuk mbulohet nga garancia e produktit.
- Përdorni mbajtëse për montim në mur dhe vida që përputhen me standardin VESA. Dëmtimi i shkaktuar nga përdorimi ose nga keqpërdorimi i përbërësve të gabuar nuk mbulohet nga garancia e produktit.



SHËNIM

- Përdorni vidat që specifikohen nga standardi VESA.
- Kompletet për montimin në mur përfshijnë udhëzuesin e instalimit dhe të gjitha pjesët e nevojshme.
- Mbajtësja për montim në mur është opsionale. Aksesorët mund t'i blini në dyqanin tuaj lokal.
- Gjatësia e vidave mund të jetë e ndryshme për çdo mbajtëse për montim në mur. Sigurohuni që të përdorni vidën me gjatësinë e duhur.
- Për më shumë informacion, ju lutemi t'i referoheni manualit të përdorimit të mbajtëses për montim në mur.

TELEKOMANDA



Përshkrimet e bëra në këtë manual bazohen në butonat e telekomandës. Ju lutem lexoni me vëmendje këtë manual që të përdorni monitorin në mënyrën e duhur.

Për instalimin e baterive, hapni kapakun e baterisë, vendosni bateritë (1,5 V AAA) duke përputhur terminalet ⊕ dhe ⊖ tek etiketat brenda kompartamentit dhe mbyllni kapakun e baterisë.

Për të bërë heqjen e baterive, bëni veprimet e instalimit në të kundërtën e tyre. Ilustrimet mund të kenë ndryshime nga pajisjet aktuale.

! KUJDES

- Mos përzieni bateritë e vjetra dhe të reja, pasi mund të dëmtoni telekomandën
- Sigurohuni të drejtoni telekomandën në drejtim të sensorit të telekomandës në monitor.
- GAME MODE (MODALITETI I LOJËS) dhe PICTURE MODE (MODALITETI I IMAZHIT) janë mbyllur, kur PBP/PIP është aktive



⏻ (POWER) Ndiz apo mbyll monitorin.

INPUT Zgjidh modalitetin e input-it (hyrjes).

Butoni i Volumit Lart/Poshtë Rregullon volumn.

MUTE Deaktivizon të gjithë tingujt.

BRIGHTNESS Rregullon ndriçimin duke shtypur butonat Lart e Poshtë në telekomandë.

MENU Lejon konfigurimin e cilësimeve të ekranit

🏠 / 📺 / 🎮 / 🖥️

Lejon konfigurimin e opsioneve të butonit duke lëvizur butonin lart/poshtë/majtas/djathtas

EXIT Del nga menyuja kryesore

OK Zgjedh menyte ose opsionet dhe konfirmon input-in tuaj.

GAME MODE Futet në karakteristikat e Lojës

PICTURE MODE Zgjedh modalitetin e imazhit

PBP/PIP Ndryshon modalitetin PBP/PIP

FULL SCREEN Konverton nën-ekranin që është në modalitetin PBP/PIP në ekran të gjerë.

AUDIO SELECT Ndryshon output-in (daljen) e audios në modalitetin PBP/PIP


PËRDORIMI I MONITORIT

Lidhja me kompjuterin

- Ky monitor mbështet veçorinë *Plug and Play.
*Plug and Play: Një veçori që ju mundëson të shtoni një pajisje në kompjuterin tuaj, pa qenë nevoja të bëni ndonjë rikonfigurim ose të instaloni ndonjë drejtues manual.

Lidhja HDMI

Transmeton sinjalet dixhitale video dhe audio nga kompjuteri dhe nga pajisjet A/V te monitori. Lidhni kompjuterin dhe pajisjen AV me monitorin me kabllon HDMI siç ilustrohet më poshtë. Shtypni butonin e menysë dhe pastaj zgjidhni opsionin e hyrjes nga menya e hyrjes.




! SHËNIM

- Nëse përdorni HDMI PC, kjo mund të shkaktojë probleme pajtueshmërie.
- Përdor kabllon të certifikuar me logon HDMI bashkëngjitur. Nëse nuk përdor kabllon të certifikuar HDMI, ekrani mund të mos shfaqet ose mund të ketë gabim lidhjeje.
- Llojet e rekomanduara të kabllave HDMI
 - Kabllon HDMI[®]/TM me shpejtësi të lartë
 - Kabllon HDMI[®]/TM me shpejtësi të lartë me Ethernet
 - HDMI 1/2 mbështet vetëm 4K@30Hz
 - HDMI 3/4 mund të mbështesë 4K@60Hz

Lidhja e DisplayPort

Transmeton sinjalet e videos dhe të audios dixhitale nga kompjuteri te monitori. Lidhni kompjuterin me monitorin duke përdorur kabllon e folesë së ekranit siç ilustrohet më poshtë. Shtypni butonin e menysë dhe më pas zgjidhni opsionin e hyrjes nga menya e hyrjes.



! SHËNIM


- Mund të mos ketë dalje të audios ose të videos, në varësi të versionit të DP-së të kompjuterit.
- Nëse përdor kabllon të zakonshme të pacertifikuara nga LG, ekrani mund të mos shfaqë figurë ose figura mund të jetë me zhurmë.

Lidhja USB-C

Transmeton video dixhitale dhe sinjale audio nga Kompjuteri juaj personal për tek monitori.


Lidhni monitorin me kompjuterin tuaj duke përdorur kabllin USB C-C siç tregohet në figurën e mëposhtme.

Shtypni butonin e menysë dhe më pas zgjidhni opsionin e hyrjes nga menya e hyrjes.



! SHËNIM

- PD (Shpërndarja e Energjisë) dhe Modaliteti Alternativ DP (DP mbi USB-C) mbështeten përmes Portit të USB-C.
- Karakteristikat mund të mos funksionojnë si duhet dhe janë të kushtëzuara nga specifikimet e aparatit të lidhur si dhe nga mjedisi.
- Porti USB-C nuk është furnizues i Energjisë së Monitorit, por një burim energjie për kompjuterin. Lidhni Adaptuesin për furnizimin me energji të monitorit.




Lidhja me pajisjet AV

Lidhja HDMI

Transmeton sinjalet dixhitale video dhe audio nga kompjuteri dhe nga pajisjet A/V te monitori. Lidhni kompjuterin dhe pajisjen AV me monitorin me kabllon HDMI siç ilustrohet më poshtë.

Shtypni butonin e menysë dhe pastaj zgjidhni opsionin e hyrjes nga menya e hyrjes.



! SHËNIM

- Përdor kablo të certifikuar me logon HDMI bashkëngjitur. Nëse nuk përdor kablo të certifikuar HDMI, ekrani mund të mos shfaqet ose mund të ketë gabim lidhjeje.
- Llojet e rekomanduara të kablove HDMI
 - Kablo HDMI®/™ me shpejtësi të lartë
 - Kablo HDMI®/™ me shpejtësi të lartë me Ethernet
 - HDMI 1/2 mbështet vetëm 4K@30Hz
 - HDMI 3/4 mund të mbështesë 4K@60Hz

Lidhja e periferikeve


Lidhja me kablo USB - kompjuter

Foleja USB në produkt funksionon si një USB.

Lutem lidhni kabllin USB C-C me kompjuterin.

! SHËNIM

- Sigurohuni që të instaloni paketën më të fundit të shërbimit të sistemit Windows përpara përdorimit të produktit.
- Pajisjet periferike shiten veçmas.
- Me folenë USB mund të lidhet tastierë, maus ose pajisje USB.
- Quick Charge (Ngarkimi i shpejtë) është i disponueshëm përmes portës USB1.
- Shpejtësia e ngarkimit mund të ndryshojë në varësi të pajisjes.




! KUJDES

Masa gjatë përdorimit të pajisjeve USB

- Pajisja USB që ka të instaluar programin e njohjes automatike ose që përdor drejtuesin e saj, mund të mos njihet.
- Disa pajisje USB mund të mos mbështeten ose mund të mos funksionojnë siç duhet.
- Rekomandohet përdorimi i një njeje USB ose i një njësie disku që furnizohet me energji. (Nëse energjia nuk mjafton, pajisja ruajtëse USB mund të mos njihet siç duhet.)
- Në rastin kur kabllin USB C-C nuk lidhet me hostin e Kompjuterit Personal, monitori mund të mos mbështesë "Charge" (Ndrysho).

- Pajisjet që jepen bashkë me produktin tuaj mund të ndryshojnë në varësi të modelit.
- Specifikimet e produktit ose përmbajtja e këtij manuali mund të ndryshohen pa njoftim paraprak për arsye që lidhen me përmirësimin e funksioneve të produktit.
- Për një lidhje optimale, kabllot HDMI dhe pajisjet USB duhet të kenë unaza më pak se 10 mm trashësi dhe 18 mm gjerësi.
- Përdorni një kabëll zgjatues që mbështet USB2.0 apo 3.0 nëse kabllin USB ose karta e memories USB nuk hyn në portën e monitorit tuaj USB.



*A ≤ 10 mm


*B ≤ 18 mm

- Përdor kablo të certifikuar me logon HDMI bashkëngjitur. Nëse nuk përdor kablo të certifikuar HDMI, ekrani mund të mos shfaqet ose mund të ketë gabim lidhjeje.
- Llojet e rekomanduara të kabllave HDMI
 - Kabllot HDMI[®]/TM me shpejtësi të lartë
 - Kabllot HDMI[®]/TM me shpejtësi të lartë me Ethernet

Lidhja me pajisjet e jashtme

Lidhja e kufjeve

Lidhni periferiket me monitorin nëpërmjet portës së kufjeve. Lidhni siç ilustrohet.




! SHËNIM

- Pajisjet periferike shiten veçmas.
- Nëse përdorni kufjet [me hark], mund të shkaktojë problem kur lidhni pajisje tjetër të jashtme me monitorin. Si rrjedhojë, rekomandohet të përdorni kufje [të drejta].



Me hark




Të drejta

- Funksionet e kufjeve dhe altoparantëve mund të kufizohen në varësi të parametrave audio të kompjuterit dhe pajisjes së jashtme.

PARAMETRAT E PËRDORUESIT

Aktivizimi i menysë kryesore

- 1 Shtypni butonin e levës në pjesën e poshtme të monitorit.
- 2 Lëvizni levën lart/poshtë (▲/▼) dhe majtas/djathtas (◀/▶) për të caktuar opsionet.
- 3 Shtypni edhe një herë butonin e levës për të dalë nga menya kryesore.



Butoni	Gjendja e menysë	Përshkrimi
	Menya kryesore e çaktivizuar	Aktivizon menynë kryesore.
	Menya kryesore e aktivizuar	Del nga menya kryesore. (Mbajtja shtypur e butonit për të fikur monitorin: Mund ta fikni monitorin në këtë mënyrë në çdo kohë, edhe kur OSD-ja është aktive)
	◀ Menya kryesore e çaktivizuar	Rregullon nivelin e vullmit të monitorit.
	▶ Menya kryesore e aktivizuar	Jep veçorinë e Input (Hyrja) .
	▶ Menya kryesore e çaktivizuar	Rregullon nivelin e vullmit të monitorit.
	▶ Menya kryesore e aktivizuar	Hyn te veçoritë e Menu (Menya) .
	▲ Menya kryesore e çaktivizuar	Shfaq informacionin në inputin aktual.
	▼ Menja kryesore e aktivizuar	Fik monitorin.
	▼ Menja kryesore e çaktivizuar	Shfaq informacionin në inputin aktual.
	▼ Menja kryesore e aktivizuar	Futni funksionet e Game .

Veçoritë e menysë kryesore



Menya kryesore	Përshkrimi
Menu (Menya)	Konfiguron parametrat e ekranit.
Game Mode	Mund të ndryshoni Picture Mode (Modalitetin e Imazhit) në një modalitet loje.
Input	Vendos modalitetin e inputit.
Power Off	Fik monitorin.
Exit(Dil)	Del nga menya kryesore.

Parametrat e përdoruesit

Parametrat e menysë

- 1 Për të parë menynë OSD, shtypni butonin e levës në pjesën e poshtme të monitorit dhe më pas hyni te Menu (Menyja).
- 2 Konfiguroni opsionet duke e lëvizur levën lart/poshtë/majtas/djathtas.
- 3 Për t'u kthyer në menynë e sipërme ose për të caktuar zëra të tjerë të menysë, lëvizeni levën në ◀ ose shtypni (● / Ok).
- 4 Nëse doni të dilni nga menyja OSD, lëvizeni levën në ◀ derisa të dilni.
 - Kur të hyni te menyja, në pjesën e poshtme djathtas të ekranit do të shfaqen udhëzime rreth përdorimit të butonit.



Quick Settings



Input



Picture




General




KUJDES

- OSD-ja (menytë në ekran) e monitorit mund të ndryshojë disi nga ajo e shfaqur në këtë manual.

Secili opsion përshkruhet në vijim.

Menyja > Quick Settings	Përshkrimi
Brightness (Ndriçimi)	Rregullon kontrastin dhe ndriçimin e ngjyrës së ekranit.
Contrast (Kontrasti)	
Volume (Volumi)	Rregullon nivelin e volumit.  SHËNIM <ul style="list-style-type: none"> • Mund të rregulloni funksionin Mute (Pa zë) / Unmute (Rikthe zërin) duke lëvizur butonin e levës në ▼ te menyja Volume (Volumi).

[PBP/PIP I MBYLLUR]

Menyja > Input	Përshkrimi	
Input List	Zgjedh regjimin e hyrjes.	
Aspect Ratio	Rregullon raportin e ekranit.	
	Full Wide	Shfaq videon në ekran të gjerë, pavarësisht hyrjes së sinjalit video.
	Original (Originale)	Shfaq videon sipas raportit të pamjes së sinjalit hyrës video.
	1:1	Raporti i pamjes nuk rregullohet nga origjinali.
	 SHËNIM <ul style="list-style-type: none"> • Ekranit mund të duket njësoj për opsionet Full Wide, Original (Originale) dhe 1:1 në rezolucionin e rekomanduar (3840 x 2160). 	
Underscan(PC Only)	Zvogëlon hapsirën e ekranit	
PBP/PIP	Ju mund të përzgjidhni kombinime të ndryshme PBP ose PIP	

[PBP/PIP I HAPUR]

Menyja > Input	Përshkrimi		
Input List (Lista e hyrjeve)	Shfaq ekranet e input-it kryesor dhe të nën input-it		
Aspect Ratio (Formati i kuadrit)	Rregullon raportin e ekranit.		
	Input-i kryesor	Full Wide (Gjerësi e plotë)	Shfaq videon për t'iu përshtatur ekranit PBP/PIP, pavarësisht hyrjes së sinjalit të videos.
		Original (Origjinale)	Shfaq videon në raportin e pamjes së hyrjes së sinjalit video në ekranin PBP/PIP.
	Nën-inputi	Full Wide (Gjerësi e plotë)	Shfaq videon për t'iu përshtatur ekranit PBP/PIP, pavarësisht hyrjes së sinjalit të videos.
Original (Origjinale)		Shfaq videon në raportin e pamjes së hyrjes së sinjalit video në ekranin PBP/PIP.	
Underscan(PC Only)	Zvogëlon hapsirën e ekranit		
PBP/PIP	Ju mund të përzgjidhni kombinime të ndryshme PBP ose PIP		
PIP Size	Vendos përmasat e Nën- dritares PIP (Small/Medium/Large) (E vogël/E mesme /E madhe)		
Transparency	Vendos opacitetin (jo-tejdukshmërinë) PIP		
Sound Out	Përzgjedh output-in (daljen) e audios në modalitetin PBP/PIP		

 **SHËNIM**



- Nëse nuk e përdorni funksionin **PBP/PIP**, atëherë **PIP Size**, **Transparency** dhe **Sound Out** çaktivizohen.

Secili opsion përshkruhet në vijim.



Menyja > Picture	Përshkrimi	
Picture Mode	Custom	E lejon përdoruesin të rregullojë secilin element. Modaliteti i ngjyrës në menyë kryesore mund të rregullohet.
	Reader	Optimizon ekranin në mënyrë që të shihen dokumentet. Ju mund të iluminoni ekranin në menunë OSD.
	Photo	Optimizon ekranin për foto.
	Cinema	Optimizon ekranin për video.
	Dark Room 1	Ky modalitet rregullon ndriçimin në nivelin optimal për punë në mjedis të errët.
	Dark Room 2	Ky modalitet cakton ndriçimin në nivel më të ulët se Dark Room 1 (Dhomë e errët 1).
	Color Weakness	Ky modalitet është për ata përdorues të cilët nuk janë në gjendje të dallojnë ndryshimin ndërmjet ngjyrës së kuqe dhe të gjelbër. Ajo i lejon përdoruesit me dobësi shikimi ndaj ngjyrave të bëjnë lehtësisht dallimin ndërmjet dy ngjyrave.
	FPS Game 1	Ky modalitet është optimizuar për lojrat në formatin FPS.
